

Hagë, 14 dhjetor 2023

PËRMBLEDHJE E AKTGJYKIMIT TË APELIT

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës, çështja gjyqësore nr. KSC-CA-2023-02

Në vijim do të gjeni përmbledhjen e Aktgjykimit të Apelit të shpallur nga Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit, lexuar nga Kryegjykatësja.

Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit është mbledhur sot për të shqiptuar Aktgjykimin e Apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*. Ky Aktgjykim shqiptohet publikisht, në emër të popullit të Kosovës, dhe në prani të të akuzuarit.

Kjo përmbledhje përmban pikat themelore të apeluara dhe konstatimet kryesore të Panelit të Apelit dhe nuk është pjesë e Aktgjykimit zyrtar dhe autoritativ të Apelit. Aktgjykimi me shkrim është i vetmi dokument autoritativ i konstatimeve të Panelit të Apelit. Aktgjykimi i Apelit do të vihet në dispozicion në formë elektronike pas kësaj seance. Një kopje e legalizuar e Aktgjykimit të Apelit në anglishte do t'i jepet z. Mustafa sot dhe versioni në gjuhën shqipe do t'i jepet kur të jetë gati.

Dhomat e Specializuara u krijuan në lidhje me akuza të rënda për trajtim çnjerëzor, vrasje të personave dhe krime të tjera të rënda të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000.

Ky Aktgjykim i Apelit shënon një moment të rëndësishëm për Dhomat e Specializuara pasi është aktgjykimi i parë i apelit në një çështje për krime lufte në këtë gjykatë. Aktgjykimi është një hap i rëndësishëm drejt vendosjes së drejtësisë për viktimat dhe llogaridhënies.

Ky Aktgjykim trajton apelin kundër konstatimeve të Trupit Gjyqësor në lidhje me përgjegjësinë e z. Mustafa, komandant i njësitit gueril BIA – një njësit i Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, ose UÇK-së – për krimet e kryera në kompleksin e Zllashit, Kosovë, më tej në tekst: kompleksi i ndalimit në Zllash, afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.

Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses shpalli Aktgjykimin, në të cilin e shpalli z. Mustafa fajtor për tri akuza për krime lufte. Ai u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme (Pikat 1, 3 dhe 4) dhe i pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor (Pika 2). Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me dënim të njësuar prej 26 vjetësh burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim. Gjatë shqiptimit të dënimit, Trupi Gjykses theksoi se z. Mustafa po gjykohej për përgjegjësinë e tij individuale dhe se në këtë proces në asnjë moment nuk po gjykohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Trupi Gjykses konstatoi se, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, ose rreth kësaj date në kompleksin e ndalimit në Zllash, që ishte bazë e njësitit gueril BIA në Zllash, të paktën gjashtë personave iu hoq liria nga anëtarë të BIA-s, që ishin nën kontrollin dhe pushtetin e komandantit të BIA-s, z. Mustafa. Trupi Gjykses konstatoi se kjo ndodhi në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se, gjatë të njëjtës periudhë kohore, z. Mustafa dhe anëtarët e tjerë të BIA-s nën pushtetin e tij, i mbajtën të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash në kushte ndalimi çnjerëzore dhe poshtëruese dhe i keqtrajtuar rregullisht, si fizikisht dhe psikologjikisht, me qëllim marrjen e informacionit ose të deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose për t'i ndëshkuar, frikësuar, detyruar dhe/ose diskriminuar për arsye politike. Së fundi, Trupi Gjykses konstatoi se personi i përmendur si viktima e vrasjes së paligjshme, u vra “afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999”, si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të z. Mustafa dhe vartësve të tij të BIA-s.

Z. Mustafa dorëzoi apel kundër verdikteve të fajësisë sipas Pikave 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës dhe një numri konstatimesh të Trupit Gjykses të bëra në lidhje me to.

Z. Mustafa kërkoi që Paneli i Apelit të prapësojë verdiktet e fajësisë dhe të shpallë vendim pafajësie ose, si alternativë, t'ia kthejë çështjen Trupit Gjykses ose të zvogëlojë dënimin e dhënë.

Z. Mustafa nuk apeloj Urdhrin për Zhdëmtim të lëshuar nga Trupi Gjykses më 6 prill 2023, në të cilin tetë viktimave pjesëmarrëse në proces iu akorduan dëmshpërblime.

Paneli i Apelit dëgjoj parashtrimet gojore të palëve dhe pjesëmarrësve më 26 dhe 27 tetor 2023.

Në apelin e tij, në të cilin përfshiheshin 9 pika të ndara në 51 nënpika, z. Mustafa parashtrij argumente në lidhje me pretendimet e tij për gabime juridike dhe faktike si dhe gabim në përcaktimin e dënimit të bëra nga Trupi Gjykses.

Paneli i Apelit së pari i referohet standardit të shqyrtimit të apeleve kundër aktgjykimeve të trupit gjykses sipas nenit 46 të Ligjit. Paneli i Apelit mund të lërë në fuqi, prapësojë ose ndryshojë aktgjykimet e trupit gjykses dhe të marrë masa të përshtatshme për arsyet vijuese: (i) gabim juridik që zhvlerëson aktgjykimin; (ii) gabim faktik që ka shkaktuar gabim gjyqsor; ose (iii) gabim në përcaktimin e dënimit. Për arsyet e shtjelluara më gjerësisht në Aktgjykimin e Apelit, Paneli rikujton diskrecionin e gjerë të Trupit Gjykses për vlerësimin e provave dhe përcaktimin e dënimit të përshtatshëm. Në lidhje me këtë Paneli thekson se nuk do t'i përmbysë lehtësisht konstatimet faktike të Trupit Gjykses, sepse trupi gjykses është në pozitën më të mirë për dëgjimin, vlerësimin dhe peshimin e dëshmimeve të paraqitura gjatë gjykimit, përveçse kur vlerësimi i [Trupit Gjykses] është tërësisht i gabuar. Gjithashtu, Paneli i Apelit nuk do të ndryshojë dënimin e dhënë nga Trupi Gjykses, përveçse kur ka bërë gabim të dallueshëm në ushtrimin e diskrecionit të vet, ose nuk ka zbatuar dispozitat ligjore përkatëse.

Para se të bëjë një përmbledhje të konstatimeve të veta, Trupi Gjykses dëshiron të nënvizojë se në disa prej pikave të apelit, z. Mustafa nuk i ka mbështetur argumentet e tij me jurisprudencën përkatëse, nuk ka evidentuar konstatimet konkrete të Trupit

Gjykues të cilat kundërshton, as u është referuar paragrafëve përkatës të Aktgjykimit, krahas mangësive të tjera. Ndonëse, në parim, mangësi të tilla përlligjin rrëzimin e menjëhershëm të pikës përkatëse të apelit, Paneli i Apelit, në disa raste, ka vendosur përjashtimisht t'i shqyrtojë ato për të qenë i drejtë me të akuzuarin dhe në interes të drejtësisë. Në raste të tjera, Paneli i Apelit i ka rrëzuar menjëherë këto argumente. Vlerësimi i Panelit të Apelit për këto raste shtjellohet më gjerësisht në Aktgjykimin e Apelit.

Paneli tani do të përmbledhë konstatimet kryesore në lidhje me Pika1 dhe 2 të Apelit të z. Mustafa. Së pari, Paneli do të trajtojë pretendimin për gabim juridik lidhur me cilësimin që Trupi Gjykues i bën konfliktit në Kosovë në periudhën përkatëse, dhe më pas do të trajtojë pretendimin për gabim faktik në lidhje me (1) pranimin prej Trupit Gjykues të disa provave dhe mbështetjen e tij në to; (2) konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me vendin e kryerjes së krimeve; (3) vlerësimin e Trupit Gjykues për dëshmitarët; dhe (4) konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me mbrojtjen përmes alibisë të z. Mustafa.

Pretendimet për gabime në lidhje me cilësimin e konfliktit prej Trupit Gjykues

Së pari, në nënpikën 1A të Apelit, z. Mustafa kundërshtoi cilësimin prej Trupit Gjykues të konfliktit në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, si konflikt i armatosur jondërkombëtar. Ai parashtrroi se ky cilësim i gabuar bënte të pavlefshëm Aktgjykimin, duke qenë se verdiktet e fajësisë së tij për krime lufte bazoheshin në nenin 14(1)(c) të Ligjit.

Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykues zbatoi kritere të sakta për vlerësimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe se z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykues gaboi në konstatimin se, nga maji 1998, UÇK-ja kishte karakteristika të mjaftueshme të një grupi të armatosur të organizuar, që ishte në gjendje të përfshihej në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.

Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses ka gabuar dhe, rrjedhimisht, rrëzon nënpikën 1A të Apelit.

Pretendimet për gabime në lidhje me pranimin prej Trupit Gjykses të disa provave dhe mbështetjen e tij në to

Z. Mustafa parashtrroi disa pika në apelin e tij, në të cilat kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me pranueshmërinë e provave të ndryshme dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në to në Aktgjykim. Këto kundërshtime përfshihen në nënpikat 1B, 1C, 1D, 1E dhe 1N të Apelit.

Së pari, në nënpikën 1B, z. Mustafa kundërshtoi pranimin si provë prej Trupit Gjykses të deklaratës së tij dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në të, me pretendimin se ishte shkelur neni 3 i Ligjit dhe rregulla 138(2) e Rregullores, si dhe e drejta e tij për të mos inkriminuar veten.

Paneli i Apelit konstaton se deklarata e tij si i dyshuar u bë në përputhje me nenin 38(3)(a) dhe (b) të Ligjit dhe rregullën 43 të Rregullores, të cilat përcaktojnë të drejtat e të dyshuarve para Dhomave të Specializuara. Paneli i Apelit gjykon se z. Mustafa u informua në mënyrën e duhur për të drejtat e tij si person i dyshuar, dhe se informacioni që mori z. Mustafa përmbush kriteret e nenit 38(3)(a) dhe (b) të Ligjit.

Paneli gjithashtu konstaton se, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, z. Mustafa nuk ka vërtetuar se pranimi i deklaratës së tij si i dyshuar ka shkelur të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten, të mbrojtur nga neni 31(1) dhe (2) i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në të.

Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses ka gabuar dhe, për rrjedhojë rrëzon nënpikën 1B të Apelit.

Së dyti, në nënpikën 1C të Apelit, z. Mustafa kundërshtoi pranimin si provë prej Trupit Gjykues të identifikimit të tij prej dëshmitarit W01679 në sallën e gjyqit dhe mbështetjen e Trupit Gjykues në këtë identifikim, me pretendimin se identifikimi ishte bërë në mënyrë të parregullt dhe, për rrjedhojë, duhej të ishte përjashtuar në bazë të rregullës 138 të Rregullores.

Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa ka humbur të drejtën për të kundërshtuar në kuadër të apelit pranueshmërinë e identifikimit, pasi ai nuk e ngriti këtë kundërshtim gjatë gjykimit dhe nuk provoi ekzistencën e rrethanave të posaçme që do të përlligjin shqyrtimin e parashtrimeve të tij për herë të parë në apel. Gjithashtu, Paneli nuk konstaton gabim në mbështetjen prej Trupit Gjykues në identifikimin e z. Mustafa prej dëshmitarit dhe, rrjedhimisht, rrëzon nënpikën 1C të Apelit.

Në lidhje me kundërshtimin z. Mustafa paraqitur në nënpikën 1D të Apelit, Paneli i Apelit konstaton se ai nuk ka vërtetuar se Trupi Gjykues gaboi që pranoi si provë, ose që u mbështet në provën materiale të quajtur "Lista e të Burgosurve". Paneli gjykon se Trupi Gjykues konstatoi tregues të mjaftueshëm autenticiteti për mbështetshmëri në atë dokument. Paneli gjithashtu konstaton, për arsyet e parashtruara në Aktgjykimin e Apelit, se Trupi Gjykues u mbështet në këtë dokument thjesht si konfirmim për prova të tjera që mbështesin konstatimin e vet në lidhje me praninë e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në nënpikën 1D të Apelit.

Në vijim, Paneli i Apelit trajton kundërshtimin e z. Mustafa në nënpikën 1E të Apelit ndaj pranimin si prova prej Trupit Gjykues të deklaratave me shkrim të disa dëshmitarëve dhe mbështetjen e Trupit Gjykues në to, në bazë të rregullave 153(1) dhe 155(1) të Rregullores, si dhe të deklaratave të bazuara në thëniet e të tjerëve të një personi tjetër.

Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në deklaratën e dëshmitarit W04648, për faktin se Trupi Gjykses, në konstatimet e veta, nuk u mbështet në asnjë pjesë të deklaratës së kundërshtuar. Paneli gjithashtu konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses gaboi që pranoi si provë deklaratën e dëshmitarit W04712 dhe gaboi në vlerësimin e saj, në të cilën Trupi Gjykses u mbështet për aq sa ajo deklaratë u konfirmua nga prova të tjera të besueshme dhe mbështetëse. Sa u përket deklaratave të bazuara në thëniet e të tjerëve, siç shtjellohet më tej në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në vlerësimin dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në këto deklarata. Paneli i Apelit gjithashtu konstaton se Trupi Gjykses nuk u dha peshë të tepruar këtyre deklaratave, por u mbështet në to si prova konfirmuese të dëshmive të tjera gojore.

Si përfundim, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e paraqitura nga z. Mustafa në nënpikën 1E të Apelit ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses.

Së fundi, në nënpikën 1N të Apelit, z. Mustafa kundërshtoi pranimin si prova të aktekspertizave mjekësore në lidhje me viktimat 08/05 dhe 09/05 sipas rregullës 132 të Rregullores.

Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa ka humbur të drejtën për ta kundërshtuar këtë pikë në apel, pasi ai nuk e ngriti këtë kundërshtim gjatë gjyimit, as nuk provoi ekzistencën e rrethanave të posaçme që do të përlligjnin shqyrtimin e parashtrimeve të tij për herë të parë në apel dhe, rrjedhimisht, e rrëzon këtë kundërshtim..

Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për vendin e kryerjes së krimeve

Në nënpikën 2A pjesërisht, 2B, 2C, 2D, 2E pjesërisht, 2F dhe 2H pjesërisht, z. Mustafa pretendoi për disa gabime faktike në konstatimet e Trupit Gjykses se krimet për të cilat u ngritën akuzat, ishin kryer në kompleksin e ndalimit në Zllash.

Së pari, në lidhje me argumentin e z. Mustafa se Trupi Gjykses e etiketoi në mënyrë të parakohshme kompleksin e shtëpive në Zllash si kompleks ndalimi, Paneli konstaton se trupat gjykuese kanë diskrecionin për t'i organizuar aktgjykimet e tyre ashtu si e gjykojnë të arsyeshme dhe se z. Mustafa nuk vërtetoi se Trupi Gjykses gaboi në ushtrimin e diskrecionit të vet në këtë aspekt.

Së dyti, në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi strehimin e BIA-s në kompleks, Paneli konstaton se, në kundërshtim me çka pretendon z. Mustafa, Trupi Gjykses ripërsëriti me saktësi thelbin e deklaratave të tij për praninë e ushtarëve të BIA-s, dhe të atij vetë, në kompleks gjatë periudhës përkatëse.

Në lidhje me argumentin e z. Mustafa se Trupi Gjykses gaboi në konstatimin se kompleksi i ndalimit në Zllash "kontrollohej" nga BIA, Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë gabim në vlerësimin prej Trupit Gjykses të provave mbi të cilat e bazoi këtë konstatim.

Z. Mustafa gjithashtu pretendoi se Trupi Gjykses gaboi që rrëzoi pretendimin e tij se ZPS-ja e mashtroi Mbrojtjen sepse e ndryshoi qëndrimin e saj lidhur me ndërtesën/ndërtesat konkrete ku pretendohet se u mbajtën të ndaluara viktimat. Paneli konstaton se argumentet e z. Mustafa janë të pabaza, duke qenë se në Aktakuzë ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte të kryera në kompleksin e ndalimit në Zllash, pa saktësuar se në cilën prej ndërtesave të kompleksit ndodhën krimet e pretenduara.

Në vijim, Paneli do të trajtojë argumentin e z. Mustafa se Trupi Gjykses gaboi në konstatimin se disa dëshmitarë të ZPS-së mundën të identifikonin vendin konkret të ndalimit. Paneli konstaton se z. Mustafa, në disa raste, shtrembëroi dëshmitë e dëshmitarëve. Paneli i Apelit gjithashtu konstaton se, siç shtjellohet më tej në Aktgjykimin e Apelit, z. Mustafa nuk ka arritur të tregojë se asnjë gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte mundur t'i pranonte dëshmitë e dëshmitarëve që identifikuan vendin e ndalimit, ose se konstatimet e Trupit Gjykses janë tërësisht të gabuara.

Në lidhje me argumentin e z. Mustafa se ZPS-ja ishte sugjестive kur u tregoi dëshmitarëve fotografitë e kompleksit të ndalimit në Zllash, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk shprehu formalisht kundërshtim gjatë gjykimit dhe nuk ka provuar ekzistencën e rrethanave të posaçme që do të përlligjnin shqyrtimin e parashtrimeve të tij për herë të parë në apel. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa e ka humbur të drejtën për ta ngritur këtë pretendim dhe rrëzon parashtrimet e tij në lidhje me të.

Si përfundim, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në nënpikën 2A pjesërisht, 2B, 2C, 2D, 2E pjesërisht, 2F dhe 2H pjesërisht, ndaj konstatimeve të Trupit Gjykues në lidhje me vendin e krimeve.

Pretendimet për gabime në vlerësimin e Trupit Gjykues për dëshmitarët

Paneli i Apelit në vijim do të trajtojë kundërshtimet e z. Mustafa në lidhje me metodologjinë që zbatoi Trupi Gjykues për vlerësimin e dëshmitarëve. Këto kundërshtime lidhen me nënpikën 1J, 2A, pjesërisht, 2E, pjesërisht, 2G, 2H, pjesërisht, 2I, 2J, 2K, 2L, 2M pjesërisht, dhe 2N të Apelit.

Paraprakisht, Paneli vëren se shumica e parashtrimeve të z. Mustafa në nënpikat 1J, 2G, 2I, 2J, 2K, 2L dhe 2M pjesërisht, të Apelit, nuk përmbushën kriteret formale për apel. Paneli konstaton se, veçanërisht në nënpikat 2K, 2L, dhe në lidhje me një argument në nënpikën 2M pjesërisht, parashtrimet e z. Mustafa në Dosjen e Apelit devijuan konsiderueshëm nga pikat përkatëse të apelit të paraqitura në Njoftimin për Apel, dhe rrjedhimisht i rrëzon menjëherë këto pika. Gjithashtu, sa i përket kundërshtimit të z. Mustafa ndaj vlerësimit të Trupit Gjykues për dëshmitarët e Mbrojtjes, paraqitur në nënpikën 1J të Apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk identifikoi konkretisht asnjë dëshmitar dhe nuk iu referua saktësisht pjesëve përkatëse në Aktgjykim, dhe për arsyet e shtjelluara më gjerësisht në Aktgjykimin e Apelit, rrëzon parashtrimet e tij në lidhje me këtë aspekt.

Paneli në vijim do të trajtojë argumentin material të z. Mustafa se Trupi Gjykues nuk vlerësoi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes kundrejt të njëjtit standard që zbatoi kur vlerësoi dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së. Paneli konstaton se Trupi Gjykues shtjelloi saktë metodologjinë e vet lidhur me vlerësimin e provave në këtë çështje gjyqësore, veçanërisht lidhur me vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, para se të mbështetej në dëshmitë e tyre. Sikurse shtjellohet me hollësi në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se Trupi Gjykues vlerësoi me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve, duke vënë në dukje çfarëdo mospërputhjes në dëshminë e një dëshmitari dhe arsyet për pranimin ose mospranimin e asaj dëshmie, në tërësi ose pjesërisht, duke mbajtur parasysh ato mospërputhje.

Më tej, sa i përket argumentit të z. Mustafa se Trupi Gjykues gaboi që presupozoi se disa dëshmitarë patën “tendencë” për të dhënë dëshmi të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në, Paneli konstaton se z. Mustafa nuk identifikoi asnjë provë në mbështetje të këtij pretendimi të përgjithshëm për njëanshmëri apo që tregonte se Trupi Gjykues nuk shqyrtoi në mënyrë objektive apo siç duhet dëshmitë e dëshmitarëve që dhanë dëshmi të favorshme për Mbrojtjen.

Paneli tani do të trajtojë argumentin e z. Mustafa se Trupi Gjykues gaboi që nuk mori parasysh dëshmitë gojore të dëshmitarëve, të favorshme për Mbrojtjen, për “arsye jorelevante”.

Së pari, Paneli vëren se, në kundërshtim me pretendimin e z. Mustafa, kur vlerësoi besueshmërinë e dëshmitarëve, Trupi Gjykues shqyrtoi dëshmitë e tyre duke u bazuar në faktet dhe ngjarjet për të cilat ishin thirrur të dëshmonin. Së dyti, Paneli gjykon se faktorët e tjerë që mori parasysh Trupi Gjykues, si lidhjet e ngushta me UÇK-në dhe/ose të akuzuarin, njëanshmëria e shprehur ndaj Dhomave të Specializuara ose ZPS-së, treguesit e përshtatjes së dëshmimeve, apo harresat, janë faktorë relevantë për besueshmërinë e dëshmitarëve dhe marrja parasysh e tyre mbështetet nga

jurisprudenca. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në lidhje me këtë aspekt.

Paneli gjithashtu rrëzon argumentin e z. Mustafa se i vetmi faktor relevant për vlerësimin e besueshmërisë është “nëse dëshmitari është ose nuk është duke e thënë të vërtetën”. Në lidhje me këtë, Paneli gjykon se Trupi Gjykes ka kompetencë të plotë diskrecionale në lidhje me peshën dhe besueshmërinë e duhur që i akordohet një dëshmitari.

Mbi bazën e sa më lart dhe arsyetimit të mëtejshëm të dhënë në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykes për besueshmërinë e dëshmitarëve që dhanë dëshmi të favorshme për Mbrojtjen dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, dhe rrjedhimisht rrëzon kundërshtimet e tjera përkatëse që z. Mustafa parashtron në pjesën e mbetur të nënpikave 1J, 2A, 2E, 2G, 2H, 2I, 2J, 2N, dhe pjesërisht nënpikën 2M të Apelit.

Z. Mustafa gjithashtu paraqiti disa pika në apel ku kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykes lidhur me besueshmërinë e disa dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre. Këto janë nënpikat 1F, 1G, 1H, 1I dhe 2P të Apelit. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në këto pika të apelit, mbi bazën se: (i) argumentet janë jashtë kuadrit të Njoftimit për Apel; (ii) z. Mustafa ka humbur të drejtën për ta kundërshtuar këtë aspekt në apel; ose (iii) z. Mustafa nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykes gaboi që u mbështet në këta dëshmitarë apo i vlerësoi gabimisht ata.

Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimin e z. Mustafa në nënpikën 1K të Apelit në lidhje me vlerësimin prej Trupit Gjykes të besueshmërisë së një dëshmitari, duke pretenduar se Trupi Gjykes gaboi që nuk mori parasysh motivin financiar të dëshmitarit për të dëshmuar dhe që nuk e lejoi Mbrojtjen t’i bënte pyetje dëshmitarit në lidhje me këtë, duke shkelur të drejtën e tij të barazisë midis palëve.

Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli gjykon se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë gabim, meqenëse Trupi Gjykses vlerësoi në hollësi besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e atij dëshmitari duke mbajtur parasysh faktorë relevantë. Paneli gjithashtu konstaton se Trupi Gjykses nuk e pengoi z. Mustafa që të kundërshtonte besueshmërinë e dëshmitarit, por vendosi kufizime të përshtatshme në lidhje me kuadrin e pyetjeve të tij për dëshmitarin.

Në përfundim, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në lidhje me këtë aspekt.

Së fundi, në nënpikën 2P të Apelit, z. Mustafa kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshminë gojore të një dëshmitari dhe që u mbështet në atë dëshmi kur nxori konstatimet në lidhje me vendin e ndalimit të viktimës së vrasjes së paligjshme dhe praninë e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës përkatëse.

Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses, meqenëse konstatimet e Trupit Gjykses pasqyrojnë saktë dëshminë gojore të dëshmitarit dhe, për më tepër, Trupi Gjykses nënvizoi me kujdes mospërputhjet në dëshminë e dëshmitarit dhe u mbështet në të vetëm për aq sa ajo u konfirmua nga dëshmi të tjera. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 2P të Apelit.

Pretendimet për gabime lidhur me shqyrtimin prej Trupit Gjykses të mbrojtjes përmes alibisë

Në nënpikat 1L dhe 1M të Apelit dhe në pjesën e mbetur të nënpikave 2M dhe 2O të Apelit, z. Mustafa kundërshtoi mosmarrjen parasysh nga Trupi Gjykses të mbrojtjes përmes alibisë, në lidhje me praninë e tij në vendin e krimeve gjatë periudhës përkatëse.

Së pari, Paneli i Apelit nuk konstaton asnjë gabim juridik sa i përket standardit për vlerësimin e mbrojtjes përmes alibisë, të përcaktuar nga Trupi Gjykses, i cili

mbështetet gjerësisht nga jurisprudenca. Konkretisht, Trupi Gjykses theksoi se nuk është e nevojshme që i akuzuari të vërtetojë alibinë jashtë dyshimit të arsyeshëm dhe me të drejtë shqyrtoi nëse provat e alibisë mund të vërtetonin *prima facie* praninë e z. Mustafa në vende të tjera dhe jo në Zllash, për të krijuar dyshim të arsyeshëm lidhur me provat e ZPS-së.

Sa u përket kundërshtimeve të z. Mustafa lidhur me konstatimet faktike të Trupit Gjykses, Paneli i Apelit konstaton - sikurse shpjegohet me më shumë hollësi në Aktgjykimin e Apelit - se Trupi Gjykses nuk gaboi në konstatimet e veta faktike lidhur me alibinë e z. Mustafa.

Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses lidhur me mbrojtjen e tij përmes alibisë në nënpikat 1L, 1M dhe 2O dhe pjesën e mbetur të nënpikës 2M të Apelit.

Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4 e Aktakuzës)

Paneli në vijim do të bëjë një përmbledhje të konstatimeve të veta lidhur me kundërshtimet z. Mustafa të paraqitura në Pikat 3, 4 dhe 5 të Apelit të tij.

Z. Mustafa kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të kimit të luftës të vrasjes së paligjshme sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, mbi të cilat u bazua verdikti i fajësisë për Pikën 4 të Aktakuzës, për vrasjen e paligjshme të viktimës së vrasjes së paligjshme, afërsisht midis 19 prillit 1999, ose rreth kësaj date, dhe fundit të prillit 1999.

Paneli së pari do të trajtojë pretendimet për gabime lidhur me veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme, të paraqitura në Pikat 3 dhe 4 të Apelit.

Sa u takon kundërshtimeve juridike të z. Mustafa lidhur me shkakësinë e vrasjes së paligjshme, Paneli rikujton se Trupi Gjykses nuk mundi të veçonte as një shkak faktik të vetëm për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme. Trupi Gjykses konstatoi se

vdekja ishte pasojë e kombinimit të keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga anëtarët e BIA-s që e mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, refuzimit të ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s që e mbajtën të ndaluar, dhe plagë nga armë zjarri.

Sa i përket shkakësisë juridike, Paneli konstaton se Trupi Gjykses zbatoi saktë standardin e “kontributit të konsiderueshëm”, i cili është i përcaktuar qartë në jurisprudencën e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë dhe të cilin, si të tillë, z. Mustafa nuk e kundërshton.

Trupi Gjykses konstatoi se keqtrajtimi i rëndë dhe refuzimi i ndihmës mjekësore si faktorë shkakësorë u “atribuohen vetëm” z. Mustafa dhe vartësve të tij të BIA-s dhe se ishin shkaqe të konsiderueshme të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme. Sa u përket vrimave të plumbave në trupin e viktimës së paligjshme, Trupi Gjykses konstatoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm nëse ato mund t’u atribuoheshin anëtarëve të BIA-s apo forcave serbe. Paneli i Apelit gjykon se, duke marrë parasysh këtë paqartësi dhe duke zbatuar parimin *in dubio pro reo*, Trupi Gjykses me të drejtë supozoi skenarin faktik më të favorshëm për të akuzuarin – gjegjësisht se forcat serbe shtinë ndaj viktimës së vrasjes së paligjshme. Për pasojë, dhe me qëllimin e atribuimit të drejtë të përgjegjësisë për vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses gjithashtu duhej të kishte vlerësuar nëse të shtënat që u supozua se erdhën nga forcat serbe, përbënin ndërhyrje relevante të një pale të tretë që ndërpret zinxhirin e shkakësisë.

Paneli fitoi njohuri kyçe në lidhje me zbatimin e duhur të parimit *novus actus interveniens* i cili përshkruan pasojat e ndërhyrjeve të tilla të palëve të treta mbi shkakësinë juridike, duke u bazuar në analizën e disa juridiksioneve të së drejtës civile dhe anglosaksone. Paneli arrin në përfundimin se një *novus actus* i tillë është relevant vetëm nëse ndërpret zinxhirin e shkakësisë në rrethana ngushtësisht të përcaktuara, përkatësisht kur ndërhyrja nuk është e parashikueshme ose nuk është pjesë e sferës së

rrezikut të parë që lidhet me të akuzuarin dhe krijon një rrezik krejtësisht të ri që është aq i madh sa e bën të papërfillshëm rrezikun e parë. Paneli i Apelit gjykon se, megjithëse nuk shqyrtoi shprehimisht parimin *novus actus interveniens*, Trupi Gjykses e bëri këtë në mënyrë të nënkuptuar dhe rrjedhimisht nuk gaboi lidhur me të. Kjo, sepse, për mendimin e Panelit të Apelit, konstatimet e Trupit Gjykses mbështesin përfundimin se të shtënat që u supozua se erdhën nga forcat serbe, nuk përbëjnë një *novus actus* relevant në kuptimin e mësipërm të ndërprerjes së zinxhirit shkakësor midis sjelljes së z. Mustafa dhe vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.

Paneli i Apelit gjithashtu rrëzon argumentin e z. Mustafa se vdekja për shkak të keqtrajtimit ose refuzimit të ndihmës mjekësore mund të mos përbëjë vrasje të paligjshme. Paneli gjykon se është përcaktuar tashmë në jurisprudencën e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë se vdekja mund të ndodhë si rezultat i një veprimi ose mosveprimi, duke i plotësuar kushtet për vrasje të paligjshme, dhe se keqtrajtimi dhe refuzimi i ndihmës mjekësore në këtë kuptim nuk dallojnë nga asnjë veprim ose mosveprim tjetër. Paneli i Apelit gjithashtu rrëzon pretendimin e z. Mustafa se duhej të bëhej konstatim në lidhje me kohën e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme. Paneli konstaton, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, se, megjithëse përcaktimi i saktë i kohës së vdekjes mund të jetë i nevojshëm në rrethana të caktuara faktike për t'i atribuar përgjegjësinë të akuzuarit, në rastin konkret nuk kishte nevojë për një përcaktim më të saktë të kohës së vdekjes se ai i dhënë.

Sa i përket argumentit të z. Mustafa në lidhje me zhvarrosjen dhe ekzaminimin *post mortem* të varrit që besohet se ishte i viktimës së vrasjes së paligjshme, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk e ngriti këtë pikë gjatë gjyimit dhe rrjedhimisht ka humbur të drejtën për ta kundërshtuar atë në apel. Për këtë arsye, Paneli i Apelit e rrëzon këtë argument.

Paneli në vijim do të trajtojë pretendimet e z. Mustafa për gabime faktike në lidhje me veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme.

Së pari, Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses nuk konstatoi jashtë dyshimit të arsyeshëm se viktima e vrasjes së paligjshme nuk qe në gjendje të qëndronte në këmbë, kur u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë. Paneli gjithashtu konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë që një konstatim i tillë ishte i domosdoshëm për përcaktimin e fajësisë së tij dhe rrjedhimisht duhej të ishte konstatuar se ishte provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Po ashtu, z. Mustafa nuk ka arritur të provojë mangësi në provat mbi të cilat u mbështet Trupi Gjykses për këtë qëllim.

Së dyti, Paneli gjykon se z. Mustafa shpërfilli referencat e hollësishme për provat në Aktgjykim, të cilat mbështesin përfundimet e Trupit Gjykses se viktima e vrasjes së paligjshme: (i) vdiq nga keqtrajtimi dhe refuzimi i ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s; (ii) nuk u evakuua; dhe (iii) u qëllua me plumba.

Së treti, sikurse shtjellohet më gjerësisht në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se përfundimi i Trupit Gjykses se vendimin për të mos e liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme nga kompleksi i ndalimit në Zllash me afrimin e forcave serbe, mund ta kishte marrë vetëm i akuzuari, u mbështet nga provat dhe rrjedhimisht rrëzon pretendimet e z. Mustafa për gabime në lidhje me këtë aspekt.

Në përfundim, dhe për arsyet e paraqitura në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses bëri gabim juridik ose faktik që konstatoi se sjellja e tij përmbushte veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme dhe rrëzon Pikat 3 dhe 4 të Apelit të z. Mustafa.

Paneli tani do të trajtojë pretendimet për gabime në konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me synimin kriminal të vrasjes së paligjshme sipas Pikës 5 të Aktakuzës.

Paraprakisht, Paneli rikujton se Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa “kishte synimin” ta vryste viktimën e vrasjes së paligjshme. Sikurse shtjellohet më në hollësi në Aktgjykimin e Apelit, megjithëse Trupi Gjykses mund ta kishte shprehur më qartë llojin e synimit që kishte z. Mustafa sipas Trupit Gjykses, si edhe përkufizimin e saktë

të atij synimi, sipas Panelit të Apelit, konstatimi i Trupit Gjykues ishte që z. Mustafa kishte synim të drejtpërdrejtë për vrasje të paligjshme.

Sa i përket argumentit të z. Mustafa se Trupi Gjykues zbatoi standardin e gabuar të synimit kriminal për krimin e luftës së vrasjes së paligjshme, Paneli gjykon se standardi i zbatueshëm i synimit kriminal është i njëjtë, pavarësisht nëse krimi është kryer përmes veprimit apo mosveprimit.

Paneli do të trajtojë në vijim argumentet e z. Mustafa se Trupi Gjykues gaboi që arriti në përfundimin se vendimi për të mos e liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme nga kompleksi i ndalimit në Zllash me afrimin e forcave serbe, efektivisht ishte barabar me një vendim për vrasjen e tij, sepse nuk u provua se ai kishte dijeni për gjendjen e viktimës së vrasjes së paligjshme. Paneli vëren se Trupi Gjykues nuk bëri shprehimisht konstatim se z. Mustafa kishte dijeni për gjendjen e viktimës së vrasjes së paligjshme. Megjithatë, Paneli gjykon se dijenia dhe synimi logjikisht mund të deduktohen nga faktet dhe rrethanat relevante për të cilat Trupi Gjykues ka bërë konstatim, të cilat shtjellohen me hollësi në Aktgjykimin e Apelit. Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë se, në mungesë të një konstatimi të tillë të formuluar shprehimisht, asnjë trup gjykues i arsyeshëm nuk mund të kishte arritur në përfundimin e Trupit Gjykues se vendimi për të mos e liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme, faktikisht ishte barabar me një vendim për vrasjen e tij.

Rrjedhimisht, dhe bazuar në arsyet e tjera të shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me synimin kriminal të krimit të luftës të vrasjes së paligjshme dhe, për këtë arsye, rrëzon Pikën 5 të Apelit dhe kundërshtimet e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit Gjykues në lidhje me Pikën 4 të Aktakuzës.

Pretendimet për gabime lidhur me konstatimet e Trupit Gjykues për krimin e luftës të torturës (Pika 3 e Aktakuzës)

Në Pikat 6 dhe 7 të Apelit, z. Mustafa kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të luftës të torturës sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit dhe argumentoi se ishte e gabuar shpallja e tij fajtor për torturimin e të paktën gjashtë personave, ndërkohë që Trupi Gjykues konstatoi vetëm se ai mori pjesë personalisht në torturimin e dy personave.

Paneli do të trajtojë së pari argumentin e z. Mustafa se elementet e veprimit të fajshëm të torturës nuk u vërtetuan, sepse dëshmitë e dëshmitarëve për keqtrajtimin fizik të tyre nuk u konfirmuan nga dëshmitarë të tjerë. Paneli konstaton se z. Mustafa e keqinterpretonte Aktgjykimin dhe shpërfill faktin se të gjithë dëshmitarët që pretendohet se ishin keqtrajtuar individualisht, dëshmuuan gjithashtu për keqtrajtimin e pësuar nga të tjerët, përfshirë edhe në praninë e tyre. Po kështu, z. Mustafa shpërfill faktin se Trupi Gjykues konstatoi që keqtrajtimi fizik nuk ishte e vetmja formë torture që pësuan të ndaluarit, por se ata ishin keqtrajtuar edhe psikologjikisht dhe ishin mbajtur në kushte çnjerëzore gjatë gjithë kohës së ndalimit në kompleksin e ndalimit në Zllash. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e z. Mustafa.

Në vijim, Paneli do të trajtojë argumentin e z. Mustafa lidhur me synimin kriminal të torturës si krim lufte, konkretisht që Trupi Gjykues nuk konstatoi, por vetëm “supozoi”, qëllimin e nevojshëm të keqtrajtimit. Paneli i Apelit konstaton se përfundimi i Trupit Gjykues se qëllimi konkret i keqtrajtimit ishte vërtetuar, mbështetet nga dëshmitë e një numri dëshmitarësh okularë dhe u arsyetua mjaftueshëm.

Së fundi, Paneli do të trajtojë argumentin e z. Mustafa në Pikën 7 të Apelit, se Trupi Gjykues gaboi kur e shpalli fajtor për torturimin e të paktën gjashtë personave, ndërkohë që Trupi Gjykues konstatoi vetëm se ai mori pjesë personalisht në torturimin e dy personave. Paneli konstaton se ai nuk ka arritur të provojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykues sa i përket verdiktit të fajësisë për krimin e luftës të torturës, në bazë të Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët I (NKP I).

Në përfundim, Paneli rrëzon Pikat 6 dhe 7 të Apelit dhe kundërshtimet e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës.

Pretendimet për gabime lidhur me konstatimet e Trupit Gjykses mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1 e Aktakuzës)

Në Pikën 8 të Apelit, z. Mustafa kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykses se ndalimi arbitrar i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar përbën krim lufte sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.

Paneli vëren se z. Mustafa në fakt ka kundërshtuar dy vendime të mëparshme të Dhomës së Gjykatës së Apelit mbi të cilët i bazoi konstatimet e veta Trupi Gjykses dhe konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë gabim juridik në vendimet e Dhomës së Gjykatës së Apelit, dhe për arsye nuk ka provuar ekzistencën e arsyeve bindëse për të devijuar nga ato vendime në interes të drejtësisë.

Paneli rrëzon gjithashtu kërkesën e z. Mustafa për t'ia referuar këtë pikë për shqyrtim Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses gaboi në lidhje me bazën juridike të krimit të luftës të ndalimit arbitrar dhe rrëzon Pikën 8 të Apelit dhe kundërshtimet e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës.

Pretendimet për gabime lidhur me konstatimet e Trupit Gjykses për dënimin

Së fundi, në Pikën 9 të Apelit, z. Mustafa kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me dënimin me 26 vjet burgim për tri Pikat e Aktakuzës për të cilat ai u shpall fajtor.

Së pari, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi në balancimin e rrethanave personale të z. Mustafa kundrejt llojit dhe peshës së krimeve dhe kontributit të tij në krimet për të cilat u shpall fajtor. Në fakt, Trupi Gjykses ka detyrimin ta bëjë këtë në bazë të kornizës juridike të Dhomave të Specializuara. Për

më tepër, Paneli i Apelit konstaton se në kundërshtim me pretendimet e z. Mustafa, Trupi Gjykues nuk e konsideroi mungesën e rrethanave lehtësuese si faktor rëndues, as nuk e përdori peshën e krimeve si rrethanë rënduese. Në lidhje me këtë, duke pasur parasysh diskrecionin e gjerë që ka Trupi Gjykues në dhënien e dënimit, Paneli i Apelit nuk konstaton asnjë gabim në faktin se Trupi Gjykues refuzoi t’u jepte peshë të qenësishme rrethanave personale të tij.

Paneli i Apelit gjithashtu rrëzon argumentin e z. Mustafa se nuk do kishte mundur t’i paraqiste rrethanat personale të tij në gjykim, sepse atij iu dhanë mundësi dhe udhëzime të shumta për ta bërë këtë dhe, gjithsesi, Paneli gjykon se Trupi Gjykues i mori parasysh ato *proprio motu*. Paneli i Apelit gjithashtu rrëzon pretendimin se Trupi Gjykues gaboi që dha një dënim me burgim për të cilin z. Mustafa pretendon se mund të tejkalojë jetëgjatësinë e pritshme të tij, sepse ky pretendim kundërshtohet nga korniza juridike e Dhomave të Specializuara që lejon dhënie dënimi deri me burgim të përjetshëm, si edhe nga jurisprudenca ndërkombëtare.

Së fundi, Paneli i Apelit do të trajtojë argumentet e z. Mustafa lidhur me zbatimin e parimit *lex mitior* dhe argumentin e tij se dënimi është tejet i gjatë. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit konstaton së pari se Trupi Gjykues konstatoi me të drejtë se nuk ishte i detyruar të zbatonte shkallëzimin e dënimeve në fuqi sipas legjislacionit të Kosovës në kohën e kryerjes së krimeve, dhe as ndonjë shkallëzim dënimesh më të butë të zbatueshëm më vonë, por se, në vend të kësaj, duhej t’i merrte parasysh në kuadër të kornizës juridike të Dhomave të Specializuara. Për arsytet që shpjegohen më me hollësi në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit konstaton se parimi *lex mitior* nuk është i zbatueshëm në raport me shkallëzimet e dënimeve sipas legjislacionit shtetëror dhe se nuk ka mospajtueshmëri ndërmjet kornizës juridike të Dhomave të Specializuara dhe Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon gjithashtu edhe kërkesën e z. Mustafa për t’ia referuar këtë pikë për shqyrtim Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, sepse Paneli i Apelit nuk ka “asnjë dyshim në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit të kundërshtuar me Kushtetutën”.

Megjithatë, Paneli i Apelit konstaton se analiza që i bëri Trupi Gjykses sistemit të dënimeve sipas legjislacionit shtetëror është e pamjaftueshme për përmbushjen e detyrimit të tij për të marrë parasysh shkallëzimet e dënimeve sipas legjislacionit shtetëror. Për këtë qëllim, si edhe në lidhje me argumentin e z. Mustafa që dënimi i tij është i tepruar, Paneli i Apelit ka analizuar jurisprudencën ndërkombëtare dhe të Kosovës në lidhje me krime lufte të krahasueshme me ato për të cilat u dënua z. Mustafa. Në kryerjen e analizës, Paneli i Apelit ishte i vetëdijshëm për faktin se dënimet nuk mund të “zhvendosen” lehtë nga një çështje gjyqësore në tjetrën, për shkak të faktorëve konkretë të çështjes gjyqësore në dhënien e dënimit.

Paneli i Apelit konstaton se në çështjet e gjykuara në tribunalë ndërkombëtarë dhe në gjykatat e Kosovës (këto të fundit të interpretuara në kontekstin e shkallëzimeve të dënimeve ekzistuese) lidhur me krime lufte të krahasueshme me ato për të cilat u dënua z. Mustafa, dënimet e dhëna ishin më të shkurtra se dënimi i z. Mustafa. Ndonëse plotësisht i vetëdijshëm për diskrecionin e gjerë të Trupit Gjykses në dhënien e dënimit, Paneli konstaton se mospërputhja ndërmjet dënimeve të z. Mustafa dhe dënimeve që analizoi Paneli, tregon se Trupi Gjykses i tejkaloi kufijtë e diskrecionit në këtë rast. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit, gjykon se, duke i dhënë z. Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme, Trupi Gjykses, ka kryer një gabim të dallueshëm në dënimin e dhënë.

Për arsye që shtjellohen në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit rrjedhimisht e gjykon të përshtatshme që dënimet individuale që iu dhanë z. Mustafa nga Trupi Gjykses t'i ulë në dënimet në vijim: (i) tetë vjet burgim për Pikën 1 të Aktakuzës, krimi i luftës i ndalimit arbitrar, i kryer kundër të paktën gjashtë personave; (ii) 20 vjet burgim për Pikën 3 të Aktakuzës, krimi i luftës i torturës, i kryer kundër të paktën gjashtë personave; dhe (iii) 22 vjet burgim për Pikën 4 të Aktakuzës, krimi i luftës i vrasjes së paligjshme, i kryer kundër një personi. Në përputhje me këtë, Paneli i Apelit tani duhet të përcaktojë gjithashtu, në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores, “një dënim të njësuar

që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit” që “nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë”. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit gjykon se një dënim i njëzuar me 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim që prej arrestimit të tij më 24 shtator 2020, pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të z. Mustafa në këtë çështje.

Paneli i Apelit vëren se konstatimet e veta lidhur me dënimin e z. Mustafa nuk ndikojnë në konstatimet Trupit Gjykses në Urdhrin për Zhdëmtim kundër z. Mustafa dhe thekson se ulja e dënimeve të z. Mustafa nuk sugjeron aspak se krimet për të cilat ai është shpallur fajtor dhe dënuar, nuk janë të rënda.

Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit pranon pjesërisht kundërshtimet e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me dënimin, dhe rrëzon pjesën e mbetur të Pikës 9 të Apelit.

Së fundi, Paneli i Apelit thekson se ka lënë në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme (Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës), për të cilat u konstatua se mbante përgjegjësi penale individuale. Dhomat e Specializuara kanë juridiksion vetëm mbi individë, jo mbi grupe apo organizata. Për këtë arsye, as UÇK-ja, as populli i Kosovës nuk ishin objekt i këtij procesi gjyqësor dhe nuk mbahen përgjegjës apo fajtorë për këto krime.

Vendim

Për arsyet e lartpërmendura, pasi ka shqyrtuar të gjitha argumentet e paraqitura nga palët dhe pjesëmarrësit, Paneli i Gjykatës së Apelit, në bazë të nenit 46 të Ligjit dhe rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

MIRATON nënpikat 9F, pjesërisht, 9H, pjesërisht, dhe 9K, pjesërisht, të Apelit të z. Mustafa;

RRËZON të gjitha aspektet e tjera të Apelit të z. Mustafa;

LË NË FUQI verdiktin e fajësisë për z. Mustafa për krimin e luftës të ndalimit arbitrar në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, sipas Pikës 1 të Aktakuzës; krimin e luftës të torturës, në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, sipas Pikës 3 të Aktakuzës; dhe krimin e luftës të vrasjes së paligjshme në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, sipas Pikës 4 të Aktakuzës;

ANULON dënimin me dhjetë vjet burgim në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me tetë vjet burgim;

ANULON dënimin me 22 vjet burgim në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me 20 vjet burgim;

ANULON dënimin me 25 vjet burgim në lidhje me Pikën 4 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me 22 vjet burgim;

ANULON dënimin e njësuar me 26 vjet burgim për z. Mustafa dhe **CAKTON** një dënim të njësuar me 22 vjet burgim për z. Mustafa, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim;

VENDOS që ky Aktgjykim të zbatohet me efekt të menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores; dhe

URDHËRON që, në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe rregullën 166(3) të Rregullores, z. Mustafa të mbetet në paraburgim të Dhomave të Specializuara deri në finalizimin e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.